



Prishtinë, 18 prill 2018

Komunikatë për media

ZRRE diskuton me palët e tjera të sektorit dhe BERZH Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtëritshme të energjisë

Dje me 17 prill 2018, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka diskutuar me palët e tjera të sektorit të energjisë (MZHE, KOSTT, REPOWER) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në lidhje me zhvillimet e deritanishme në sferën e investimeve të reja nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe mbështetjen e këtyre investimeve përmes Skemës Mbështetëse.



Takim konsultativ në mes ZRRE, MZHE, KOSTT EBRD dhe REPOWER

Përfaqësues të BERZH janë interesuar të dinë në lidhje me implikimet që paraqesin caqet e reja të vendosura nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) në tarifat e energjisë elektrike si dhe trajtimin e këtyre caqeve në Skemën Mbështetëse të përcaktuar nga ZRRE.

Përfaqësues të ZRRE me këtë rast kanë theksuar se arritja e caqeve, të caktuara nga Bashkimi Evropian për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme për 25% nga prodhimi i përgjithshëm vendor, është një nga prioritetet kryesore të sektorit të energjisë në vend dhe se ZRRE bazuar në rëndësinë që kanë këto investime do të trajtoj me kujdesin më të madh përfshirjen e tyre në Skemën Mbështetëse duke u përpjekur që ndikimi të jetë sa më i vogël në tarifat e energjisë elektrike të cilat ZRRE është e obliguar ti caktoj duke marrë parasysh edhe përbalueshmërinë nga konsumatorët.